



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/03
Datë: 19.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështjet Penale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Francës.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë që të zhvillojë negociatat me Qeverinë e Republikës së Francës me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes së lartëcekur, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë